



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
MINISTRI

Nr. 4140/prot.

Data: 02.06, 2026

VENDIM

Nr. 240, Datë 02.06, 2026

Bazuar në pikën 2 të nenit 25 të ligjit nr. 15/2017, datë 16.02.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Urdhrin e Ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 845, datë 03.07.2025, “Për miratimin e rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional”, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e ofruesit të AFP-së, paraqiten të dhënat si më poshtë:

1. **Emri i ofruesit të AFP-së:** Shkolla e Mesme Profesionale “Hoteleri Turizëm”, Tiranë.
2. **NIPT :** J62215005C.
3. **Organizimi i institucionit:** Shkollë e mesme profesionale publike.
4. **Lloji i ofruesit të AFP-së:** Shkollë e mesme profesionale

Pasi mora në shqyrtim raportin përfundimtar të vlerësimit të jashtëm për akreditim, si dhe të gjithë procedurën e akreditimit, të zbatuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFP),

Konstatoj se:

- a) procedura dhe procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditim janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara për këtë proces;
- b) vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në dokumentacionin e vlerësimit të jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në terren;
- c) raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm,

VENDOS:

Akreditimin e Ofruesit Shkolla e Mesme Profesionale “Hoteleri Turizëm”, Tiranë për kualifikimet profesionale II -IV të KSHK-së si më poshtë vijon:

1. Teknologji Ushqimore”, Niveli II i KSHK-së, A-II-21
2. “Teknologji e Përpunimit të Brumrave”, Niveli III i KSHK-së, A1-III-22
3. “Teknologji Ushqimore”, Niveli IV i KSHK-së, A-IV-23
4. “Hoteleri-Turizëm”, Niveli II i KSHK-së, G-II-22
5. “Bar-Restorant”, Niveli III i KSHK-së, G1-III-24
6. “Kuzhinë-Pastriçeri” (Pilot), Niveli III i KSHK-së, G2-III-22
7. “Reception” (Duale), Niveli III i KSHK-së, G3-III-24
8. “Shërbime në Hotel dhe Restorant”, Niveli III i KSHK-së, G5-III-24
9. “Kuzhinë” (Duale), Niveli III i KSHK-së, G8-III-24
10. “Hoteleri-Turizëm, Niveli IV i KSHK-së, G-IV-25
11. “Kuzhinë”, Niveli III i KSHK-së, G8-III-24, VET-by-EHL
12. “Hoteleri”, Niveli III i KSHK-së, G9-III-24, VET-by-EHL
13. “Shërbime Ushqimi dhe Pije”, Niveli III i KSHK-së, G10-III-24, VET-by-EHL

Afati i akreditimit fillon me datën e daljes së këtij vendimi dhe ka vlefshmëri 4 vjet.

Ofruesi i AFP-së duhet të plotësojë rekomandimet e raportit përfundimtar të akreditimit referuar shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi, në përputhje me propozimin përkatës nr.101/5, datë 20.04.2026, ardhur nga AKAFPK-ja.

Ofruesi i AFP-së t’i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik institucional sipas kuadrit ligjor në fuqi, çdo 4 vjet.

Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe për monitorimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të akreditimit, sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


MINISTËR
Delina Ibrahimaj